

R E L A C I O N
PËR
PROJEKTLIGJIN
PËR
DISA NDRYSHIME NË LIGJIN Nr.9154, datë 6.11.2003
“PËR ARKIVAT”, I NDRYSHUAR

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektligj synon të ndryshojë varësinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, nga Kryeministria që është aktualisht, në varësi të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektvendim nuk është parashikuar në Planin e Përgjithsëm Analitik të Projektakteve për vitin 2026.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ky ndryshim vjen në vijim të gjetjeve nga Raporti i SiGMA i kryer në vitin 2025, lidhur me “Forcimin e qendrës së qeverisjes në Shqipëri”. Objekti kryesor i këtij raporti kishte të bënte me vlerësimin e situatës aktuale si dhe dhënien e rekomandimeve me fokus forcimin e qendrës së qeverisjes së Shqipërisë, duke integruar në mënyrë efektive parimet e Qeverisjes së Përbashkët në përputhje me parimet e Administratës Publike, veçanërisht ato që lidhen me koherencën e politikave, planifikimin strategjik, hartimin e politikave të bazuara në prova dhe konsultimin me palët e interesuara, duke mbështetur kështu vendin në rrugëtimin drejt anëtarësimit në BE, e njëkohësisht duke siguruar qeverisje më efektive, ofrim më të mirë të shërbimeve dhe zbatim të qëndrueshëm të politikave. Raporti, ndër të tjera ka evidentuar shpërndarjen e përgjegjësisë që kanë qendrat e qeverisjes në vendet e OECD-së, të cilat konsistojnë kryesisht në funksionet

kritike të qeverisjes, të tilla si koordinimi i mbledhjeve të Kabinetit, planifikimi strategjik për të gjithë qeverinë, përgatitja e programit të qeverisë dhe monitorimi i zbatimit të politikave. Në këtë kontekst, është vlerësuar se këto praktika ndërkombëtare ofrojnë njohuri të vlefshme edhe për Shqipërinë, e cila po kalon reforma gjithëpërfshirëse të qeverisjes si pjesë e procesit të pranimit në BE, duke kontribuar në identifikimin e ekuilibrit optimal midis koordinimit të centralizuar dhe mbikëqyrjes strategjike nga njëra anë, dhe delegimit efektiv dhe bashkëpunimit ndërministror nga ana tjetër, duke rritur ndjeshëm koherencën e politikave, efikasitetin administrativ dhe efektivitetin e qeverisjes.

Nga sa më lart, raporti ka kryer edhe një vlerësim të situatës aktuale në Shqipëri, duke theksuar se struktura administrative mbetet shumë e centralizuar, me 26 autoritete dhe agjenci që raportojnë drejtpërdrejt te Zyra e Kryeministrit.

Në këto kushte, është rekomanduar një reduktim i numrit të institucioneve në varësi të Kryeministrit, duke bërë edhe sugjerimet konkrete për kalimin e varësisë së këtyre institucioneve. Konkretisht për Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave është sugjeruar të jetë institucion në varësi të ministrit përgjegjës për kulturën.

Në këtë kuadër, Ministria përgjegjëse për kulturën, referuar fushës së përgjegjësisë, si dhe duke pasur në konsideratë që Institucionet e Rrjetit Arkivor Kombëtar janë institucione të specializuara në kuptim të ligjit 27/2018 “Për trashëgiminë Kulturore dhe muzetë”, i ndryshuar, përbën autoritetin më të përshtatshëm për mbikëqyrjen dhe koordinimin e veprimtarisë së këtij institucioni.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj mbështetet në nenet 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektvendim nuk synon përafrim me asnjë *acquis communautaire*.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ky projektligj përbëhet nga 7 nene si vijon:

Neni 1

Në pikën 2 të nenit 10 togfjalëshi "...në varësi të Kryeministrit..." zëvendësohet me togfjalëshin "*...në varësi të ministrit përgjegjës për kulturën/arkivat...*"

Neni 2

Pika 1 e nenit 11 riformulohet si vijon:

1. Drejtori i Përgjithshëm është titullari i institucionit. Ai emërohet, lirohet, apo shkarkohet nga detyra me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për kulturën/arkivat dhe kryen këto detyra:

Neni 3

Shkronja "a" e pikës 1 të nenit 11 riformulohet si vijon:

a) përgjigjet përpara ministrit përgjegjës për kulturën/arkivat për veprimtarinë e institucionit;

Neni 4

Në nenin 11, pas pikës 2 shtohet pika 3 me përmbajtjen si vijon:

3. Kandidati për pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm duhet të plotësojë kriteret si më poshtë:

a) të jetë shtetas shqiptar;

b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

c) të ketë të paktën 10 (dhjetë) vjet përvojë pune në fushën arkivore;

ç) të ketë diplomë të nivelit "Master i shkencave";

d) të ketë integritet moral dhe profesional;

dh) të mos jetë dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

e) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi;

ë) të mos ketë konflikt interesi në ushtrimin e detyrës.

Neni 5

Neni 82 riformulohet me përmbajtjen si vijon:

“Paraqitja e dokumenteve të Fondit Arkivor të Republikës së Shqipërisë, në mjedise ndërkombëtare kryhet sipas ligjit për trashgiminë kulturore dhe muzetë”.

Neni 6

Në nenin 83, togfjalëshi “...me vendim të Këshillit të Ministrave.” zvendësohet me togfjalëshin “...sipas ligjit për trashgiminë kulturore dhe muzetë.”

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Ngarkohet për zbatimin e këtij projektakti Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Inovacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektakt është hartuar nga Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit.

Projektvendimi është dërguar për mendim tek Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Ministri i Shtetit për Administratën dhe Antikorrupsionin.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Nuk ka efekte financiare shitesë që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi duke marrë në konsideratë transferimin e fondeve buxhetore te miratuara për këtë institucion me ligjin e buxhetit për vitin 2026

**MINISTRI
BLENDI GONXHJA**